



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

ADGJA.nr.02/2024

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga R.C., Sh.F., Xh.O., Rr.B., G.M. dhe G.D., e parashtruar përmes mbrojtësit të tyre av.M.A. nga P..., ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, N.M., G.Ll. dhe L.M., lidhur me vendosjen në lëndën Ac.nr.4395/20, të Gjykatës së Apelit në Kosovë, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datën 16.04.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga R.C., Sh.F., Xh.O., Rr.B., G.M. dhe G.D., ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, N.M., G.Ll. dhe L.M., lidhur me vendosjen në lëndën.Ac.nr.4395/20, të Gjykatës së Apelit në Kosovë.

### A r s y e t i m

Me datën 29.04.2024, nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Gjykata e Apelit e Kosovës, e ka pranuar ankesën e R.C., Sh.F., Xh.O., Rr.B., G.M. dhe G.D., e parashtruar përmes mbrojtësit të tyre av.M.A., nga P... Në ankesë i njëjti ka pretenduar se kolegji gjykues i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në përbërje të sipër cituar, lëndën Ac.nr.4395/20 të datës 02.11.2023 e ka marrë në gjykim për herë të tretë, sipas ankesës së palës së paditur, N... Bankë “P.” në P..., ankesë kjo e parashtruar ndaj aktgjykimit të tretë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.1182/18 i datës 11.10.2019. Kolegji gjykues i Gjykatës së Apelit, me aktvendimin e tretë, aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të gjykuar për herë të tretë, sipas ankesës së tretë me radhë të palës së paditur e ka prishë në tërësi dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje të katërtën herë me radhë në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Tutje ka shtuar se kolegji i kësaj lënde, me rastin e gjykimit të tretë me radhë, si gjykatë e shkallës së dytë, ka injoruar dispozitat e nenit 190.1, 190.2 e në veçanti dispozitën e nenit 190.3 të LPK dhe me këtë ka bërë shkelje flagrante të punës dhe detyrave të gjyqtarit, duke e prishur në tërësi aktgjykimin e tretë me radhë të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe duke e kthyer lëndën në rigjykim dhe rivendosje për herë të katër, pa caktuar seancë të shqyrtimit të drejtpërdrejtë. Kthimi në rigjykim të katër i kësaj lënde të thjeshtë nga marrëdhënia e punës dhe zvarritja e kësaj lënde, në rreth vicioz nga ana e Gjykatës së Apelit është padrejtësi skandaloze dhe me qëllim të caktuar nga ana e kolegjeve gjykues të kësaj gjykate.

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit dhe vlerësimit të ankesës, me datë 03.04.2024, nga gjyqtarët N.M. dhe L.M., në lëndën Ac.nr..4395/20, ka kërkuar deklaram lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesit R.C., Sh.F., Xh.O., Rr.B., G.M. dhe G.D..

Gjyqtari N.M., ka dhënë deklaratë me datën 04.04.2024, ku ka theksuar se lënda nuk është prishur tri herë nga Gjykata e Apelit, pasi herën e parë është prishë nga Gjykata e Qarkut dhe tani më është qëndrim edhe i praktikës se tri herë sipas dispozitave të LPK konsiderohet nëse është prishë nga ana e Gjykatës së Apelit, pra nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit dhe se nuk ka shkelje nga neni 190 i LPK. Tutje ka shtuar se qëndrojnë në tërësi pranë vendimmarrjes sikurse në vendimin e atakuar dhe deri të vendimmarrja ka ardhur nga shkeljet e evidentuara nga ana e Gjykatës së Apelit e që nuk janë përfillur në masë të madhe nga instanca e shkallës së parë. Është ligji ai që na garanton të drejtën e gjykimit të pavarur duke u mbështetur në vlerësimin e provave dhe çështjes gjithmonë duke iu shmangur vlerësimin arbitrar. Ka theksuar se në vlerësim si kryetar i kolegjit dhe në bindje të palëkundur në prishje nuk ka pasur asnjë ndikim e as luhate as më të vogël pra pretendimi se kolegji ka luajtur rolin e avokatit të palës kundërshtarë është totalisht i pa qëndrueshëm, kolegji ka luajtur rolin sipas ligjit, pasi për shkelje të dispozitave të procedurës lënda nuk mund të ndryshohet kjo qëndron sipas ligjit.

Gjyqtari L.M., ka dhënë deklaratë me datën 04.04.2024, ku ka theksuar se në bazë të raportimit të gjyqtarit referues, si anëtarë i kolegjit ka vlerësuar se aktgjykimi i atakuar nuk i plotëson konditat ligjore për vërtetimin apo ndryshimin e tij, për shkak se ka qenë i përfshirë me shkelje të ligjit të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe domosdoshmërishtë është dashur që të aprovohet ankesa e palës ankuese dhe të priset aktgjykimi dhe çështja të kthehet në rigjykim të serishëm sepse në rastin konkret nuk janë zbatuar të gjitha sugjerimet nga ana e gjykatës së shkallës së parë, me qëllim që të merret një vendim i drejtë dhe i ligjshëm, po ashtu çështja juridike është trajtuar me objektivitet dhe profesionalizëm të lartë, prandaj ka propozuar që të refuzohet ankesa e palës si e pabazuar.

Ankesa disiplinore është parashtruar edhe ndaj anëtarit tjetër të kolegjit gjyqtarit G.L., mirëpo meqenëse i njëjti është pensionuar me datë 07.12.2023, Kryetari i Gjykatës së Apelit nuk ka kërkuar deklaratën e të njëjtit.

Kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimin të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarit N.M. dhe L.M., ka gjetur se:

- ankesa e ankuesve R.C., Sh.F., Xh.O., Rr.B., G.M. dhe G.D., e parashtruar përmes mbrojtësit të tyre av.M.A. nga P..., është e **pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesit si dhe deklaratave të gjyqtarëve, vlerësoi se pretendimet ankimore sa i përket mënyrës së vendosjes, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se gjyqtarët janë të pavarur në vendimmarrje, pavarësi kjo e cila i'u është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu gjyqtarët janë të pavarur në punë e tyre, vendosin sipas ligjit dhe vendimet merren në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim kryesor. Sipas vlerësimin të kryetarit, pavarësia individuale, është pavarësia e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre gjyqësor, që nënkupton se gjyqtarët duhet të jenë meritore, objektiv, neutral dhe të liruar nga çdo ndjenjë e ndikimit kur ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor.

Duke u bazuar në deklaratat e gjyqtarëve rezulton se aktgjykimi herën e parë është prishur nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe meqenëse Ligji i Procedurës Kontestimore Nr.03/L-006 nuk ka veprim retroaktiv rezulton se në Gjykatën e Apelit është prishur vetëm dy herë andaj edhe nuk paraqet shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Lidhur me pavarësinë në vendimmarrje nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje të pavend apo të pajustificuar në procesin gjyqësor dhe nuk duhet që vendimet gjyqësore të gjykatave t'i nënshtrihen ndryshimit. Në rastin konkret Kryetari i Gjykatës nuk ka kompetencë që të ndryshojë vendimet gjyqësore të nxjerra nga gjyqtari apo kolegji i gjyqtarëve dhe se pala e pakënaqur ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nëse vlerëson se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, i njëjti eventualisht mund të parashtrijë kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ndërsa nëse vlerëson se ka baza të tjera ankimore, atëherë i njëjti eventualisht mund t'i drejtohet Gjykatës Supreme.

Kryetari i Gjykatës vlerësoi, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me vendosjen e çështjes së parashtruesve të ankesës, meqë me prova të shqyrtuara nuk është vërtetuar se gjyqtari N.M. dhe L.M. ka bërë shkelje të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Ndërkaq, për punën profesionale të gjyqtarit apo kolegjit, kompetent për vlerësim profesional është Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i cili vepron në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku i njëjti bën vlerësimin e performancës për gjyqtarët.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**ADGJA.nr.02/2024, me datë 16.04.2024**

**Kryetari i Gjykatës**  
**Valon Totaj**

***Vendimi t'i dorëzohet:***

- Parashtruesit të ankesës,
- Gjyqtarit N.M.,
- Gjyqtarit L.M.
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës,